

Deklarata e Bolonjës



Exported from Wikisource on February 10, 2023

Deklarata e Bolonjës
nga Ministrat e Arsimit të Evropës
19 Qershor 1999

Marrë nga

Falë arritjeve të jashtëzakonshme të viteve të fundit, procesi Evropian po bëhet gjithnjë e më tepër një realitet i prekshëm e konkret për Unionin (Evropian) dhe qytetarët e tij. Perspektiva e zgjerimit dhe thellimi i marrëdhënieve me vendet e tjera evropiane, i ofrojnë një dimension tjetër më të gjerë këtij realiteti.

Aktualisht, jemi dëshmitarë të rritjes së ndërgjegjësimit publik në një pjesë të madhe të botës politike, akademike dhe të opinionit publik në përgjithësi, mbi nevojën e krijimit të një Evrope më të plotë e më të shtrirë gjeografikisht që do të mbështetet dhe zhvillohet tek dimensionet e saj intelektuale, kulturore, sociale, shkencore dhe teknologjike.

"Evropa e Njohurive" (A Europe of Knowledge) vlerësohet tashmë si një faktor i pazëvendësueshëm i zhvillimit social dhe njerëzor dhe në të njëjtën kohë edhe si një komponent i rëndësishëm për konsolidimin dhe zhvillimin e qytetarisë evropiane nëpërmjet pajisjes së qytetarëve të saj me njohuritë e nevojshme

për të përballuar sfidat e mijëvjeçarit të ri si dhe nëpërmjet ndërgjegjësimit për vlerat dhe trashëgiminë e një hapësire të përbashkët sociale dhe kulturore.

Rëndësia e bashkëpunimit arsimor dhe jo-arsimor në zhvillimin dhe fuqizimin e shoqërive të qëndrueshme, paqësore e demokratike vlerësohet nga të gjithë si shumë e rëndësishme, aq më tepër në kontekstin e situatës në Evropën jug-lindore.

Deklarata e Sorbonës e 25 Majit 1998, e cila nënvizon pikërisht këto konsiderata, ndërmjet të tjerash thekson edhe rolin qendror të Universiteteve në zhvillimin e dimensionit kulturor Evropian. Në këtë deklaratë theksohet krijimi i hapësirës evropiane të arsimit të lartë si një rrugë kyçe për promovimin e mobilitetit dhe punësimit të qytetarëve nga njëra anë dhe për zhvillimin e përgjithshëm të kontinentit nga ana tjetër.

Disa vende evropiane tashmë e kanë pranuar ftesën për t'u angazhuar për arritjen e objektivave të përcaktuara në këtë deklaratë dhe e kanë nënshkruar atë apo kanë shprehur aprovimin e tyre. Gatishmëria e disa qeverive për të ndërmarrë hapa konkrete është provuar nga reformat e arsimit të lartë që po zbatohen në disa nga këto vende.

Institutet evropiane të arsimit të lartë (nga ana e tyre), e kanë pranuar sfidën dhe si rrjedhim kanë marrë një

rol kryesor si në ndërtimin e hapësirës evropiane të arsimit të lartë ashtu dhe në ringjalljen e parimeve themelore të Bologna Magna Charta Universitatum të 1998. Ky fakt merr një rëndësi mjaft të madhe po të marrim në konsideratë se pavarësia dhe autonomia e Universiteteve garantojnë që arsimit të lartë dhe sistemet e kërkimit duhet që në mënyrë të vazhdueshme të adaptohen në përputhje me ndryshimet e nevojave dhe kërkesave të shoqërisë si dhe me ndryshimet e ardhura si pasojë e zhvillimit të shkencës në tërësi.

Aktualisht është përcaktuar si drejtimi ashtu dhe qëllimi i rrugës që duhet ndjekur. Arritja e një baze më të mirë për përputhshmërinë dhe krahasueshmërinë e sistemeve të arsimit të lartë nuk mund të realizohet pa një përpjekje të vazhdueshme. Ne duhet ta mbështesim atë nëpërmjet promovimit të masave dhe planeve për realizimin e hapave konkrete në këtë drejtim. Në takimin e 18 Qershorit morën pjesë shumë ekspertë dhe akademikë me reputacion nga të gjitha vendet tona, të cilët na ndihmuan me mjaft sugjerime dhe iniciativa që do të duhet të konsiderohen.

Një vëmendje mjaft të veçantë duhet t'i kushtojmë objektivit për rritjen e konkurrencës ndërkombëtare në sistemin evropian të arsimit të lartë. Vitaliteti dhe efikasiteti i çdo civilizimi mund të matet nga jehona e kulturës së tij në vendet e tjera. Ne duhet të sigurojmë që sistemi evropian i arsimit të lartë të fitojë një

shkallë të lartë tërheqjeje në mbarë botën, të njëjtë me ate të traditës kulturore dhe shkencore.

E ndërsa shprehim mbështetjen për parimet e përgjithshme të përcaktuara në deklaratën e Sorbonës, ne angazhohemi për koordinimin e politikave tona për të arritur në një kohë të shkurtër (dhe sidoqoftë brenda dekadës së parë të mijëvjeçarit të tretë), objektivat e mëposhtme, të cilat në i konsiderojmë si prioritare për krijimin e një hapësire evropiane të arsimit të lartë dhe për promovimin e sistemit evropian të arsimit të lartë në mbarë botën:

Adoptimi i një sistemi të gradave shkencore lehtësisht të njohshme dhe të krahasueshme, gjithashtu përmes Supplementit të Diplomës, me qëllim që të nxitet aftësia për punësim e qytetarëve evropianë dhe konkurrenca ndërkombëtare e sistemit evropian të arsimit të lartë.

Adoptimi i një sistemi kryesisht të bazuar në dy cikle kryesore, universitare dhe të diplomuar me grada shkencore. Promovimi për në ciklin e dytë do të kërkojë plotësimin e sukseshëm të ciklit të parë të studimeve, që zgjat në një minimum prej tre vjetësh. Grada shkencore që jepet mbas ciklit të parë do të njihet në tregun evropian të punës si një nivel i përshtatshëm kualifikimi. Cikli i dytë do të çojë në

titullin master dhe/ose doktoratë si në shumë vende Evropiane.

Vendosja e sistemit të krediteve -te tilla si sistemi ECTS - si një mjet i përshtatshëm për nxitjen e lëvizshmërisë më të gjerë të studentëve. Kreditet gjithashtu mund të përftohen dhe në kontekstin e arsimit jo-të lartë, duke përfshirë të mësuarit gjatë gjithë jetës, duke siguruar që ato të njihen nga universitetet e interesuara.

Promovimi i lëvizshmërisë (Mobiliteti) duke kapërcyer pengesa drejt të ushtruarit të efektshëm të lëvizjes së lirë, me vëmendje të veçantë ndaj:

- studentëve, mundësive të tyre për studim, trainim dhe shërbime që lidhen me to,
- për pedagogë, kërkues dhe staf administrativ, njohje dhe vlerësim i periudhave të harxhuara në punë kërkimore brenda kontekstit Evropian, mësimdhënie dhe trainim, pa paragjykuar të drejtat e tyre statusore.

Promovimi i bashkëpunimit evropian në sigurimin e cilësisë me synim zhvillimin e kriterëve dhe metodologjive krahasuese.

Promovimi i dimensioneve të nevojshme evropiane në arsimin e lartë, veçanërisht në lidhje me zhvillimin e kurrikulës, bashkëpunimit ndër-institucional, skemave

të lëvizshme dhe programeve të integruara të studimit, trajnimit dhe kërkimit.

Ne angazhohemi që të arrijmë këto objektiva brenda kuadrit të kompetencave tona institucionale duke respektuar plotësisht diversitetin e kulturave, gjuhëve, sistemeve kombëtare të arsimit dhe autonominë universitare , për konsolidimin e hapësirës evropiane të arsimit të lartë. Për këtë qëllim, ne do te ecim në rrugën e bashkëpunimit ndërqeveritar, së bashku me ato organizata joqeveritare evropiane të cilat kanë kompetenca mbi arsimin e lartë. Ne shpresojmë që përsëri, universitetet të reagojnë me shpejtësi, pozitivisht dhe të kontribuojnë në mënyre aktive për suksesin e kësaj iniciative.

Të bindur se krijimi i hapësirës evropiane të arsimit të lartë, kërkon në mënyrë konstante: mbështetje, supervizion dhe adoptim ndaj nevojave që janë në ndryshim të vazhdueshëm, ne vendosim që të takohemi përsëri brenda dy vjetësh me qëllim që të vlerësojmë progresin e arritur dhe hapat e reja që do të duhet të ndërmerren.

Nënshkruesit:

Caspar EINEM

Jan ADE

Drejtor i Përgjithshëm

Ministër i Shkencës
dhe Transportit

(Austri)

Ministria e Komunitetit Flemeng

Departamenti i Arsimit

(Belgjike)

Gerard SCHMIDT

Drejtor i Përgjithshëm
i Komunitetit Francës

Ministria e Arsimit të
Lartë dhe Shkencës

(Belgjike)

Eduard ZEMAN

Ministër i Arsimit, Rinisë dhe
Sporteve

(Republika Çeke)

Anna Mmia

TOTOMANOVA

Zv. Ministre e Arsimit
dhe Shkencës

(Bullgari)

Tonis LUKAS

Ministër i Arsimit

(Estoni)

Margrethe

VESTAGRER

Claude ALLEGRE

Ministre e Arsimit
(Danimarkë)

Ministër i Arsimit Kombëtar,
Kërkimit Shkencor e Teknologjisë
(Francë)

Maija RASK

Ute ERDSIEK-RAVE

Ministre e Arsimit, Shkencës,
Kërkimit Shkencor e Kulturës për
landin e Scheswig-holstein

Ministre e Arsimit dhe
Shkencës

Wolf-Michael CATENHUSEN

(Finlandë)

Sekretari Parlamentar i Shtetit

Ministria Federale e Arsimit dhe
Shkencës

(Gjermani)

Adam KISS

Gherassimos ARSENIS

Zv. Ministër Shtetit për
Arsimin e Lartë dhe
Shkencën

Ministër i Arsimit Publik dhe
Çështjeve Fetare

(Hungari)

(Greqi)

Pat DOWLING

Gudridur SIGURDARDOTTIR

Sekretar i Përgjithshëm Sekretar i Përgjithshëm

Ministria e Arsimit dhe
Shkencës

Ministria e Arsimit Kulturës dhe
Shkencës

(Irlandë)

(Islandë)

Tatjana KOKEK

Ortensio ZECCHINO

Ministre Shteti për
Arsimin e Lartë dhe
Shkencën

Ministër i Universiteteve, dhe
Kërkimit Shkencor dhe
Teknologjik

(Latvia)

(Itali)

Erna HENNICOT-
SCHOEPGES

Kornelijus PLATELIS

Ministre e Arsimit
Kombëtar dhe Arsimit
Profesional

Ministër i Arsimit dhe Shkencës

(Lituani)

(Luksemburg)

Loek HERMANS

Louis GALEA

Ministër i Arsimit, Ministër i Arsimit
Kulturës i Arsimit,
Kulturës dhe Shkencës **(Malta)**

(Hollandë)

Wilibald WINKLER Jon LILLETUN

Zv. Ministër Shteti për Ministër i Arsimit, Kërkimit
Arsimin Kombëtar Shkencor dhe Kishës

(Poloni)

(Norvegji)

Andrei MARGA

Eduardo Marçal GRILO

Ministër i Arsimit
Kombëtar

Ministër i Arsimit

(Rumani)

(Portugali)

Pavel ZGAGA

Milan FTACNIK

Ministër Shteti për
Arsimin e Lartë

Ministër i Arsimit

(Slloveni)

(Republika Sllovake)

Agneta BLADH

D.Jorge FERNANDEZ DIAZ

Ministre Shteti për
Arsimin dhe Shkencën

(Suedi)

Ministër Shteti për Arsimin,
Universitetet, Kërkimin Shkencor
dhe Zhvillimin

(Spanjë)

Tessa BLACKSTONE Charles KLEIBER

Ministre Shteti për
Arsimin dhe Punësimin

(Angli)

Ministër Shteti për Shkencën dhe
kërkimin Shkencor

(Zvicër)

About this digital edition

This e-book comes from the online library [Wikisource](#)^[1]. This multilingual digital library, built by volunteers, is committed to developing a free accessible collection of publications of every kind: novels, poems, magazines, letters...

We distribute our books for free, starting from works not copyrighted or published under a free license. You are free to use our e-books for any purpose (including commercial exploitation), under the terms of the [Creative Commons Attribution-ShareAlike 3.0 Unported](#)^[2] license or, at your choice, those of the [GNU FDL](#)^[3].

Wikisource is constantly looking for new members. During the realization of this book, it's possible that we made some errors. You can report them at [this page](#)^[4].

The following users contributed to this book:

- Cradel
- Hipi Zhdripi~sourceswiki
- Koavf

1. [↑ https://wikisource.org](https://wikisource.org)
2. [↑ https://www.creativecommons.org/licenses/by-sa/3.0](https://www.creativecommons.org/licenses/by-sa/3.0)
3. [↑ https://www.gnu.org/copyleft/fdl.html](https://www.gnu.org/copyleft/fdl.html)
4. [↑ https://wikisource.org/wiki/Wikisource:Scriptorium](https://wikisource.org/wiki/Wikisource:Scriptorium)